



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KUVENDI**  
*Komisioni për Integrimin Europian*

Dokument parlamentar

**PROCESVERBAL**

Datë 20.04.2015, ora 11:00

**Drejton mbledhjen:**

**Majlinda Bregu – kryetare e Komisionit**

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 16.04.2015.
2. Shqyrtimi i projektligjit “Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë”.
3. Të tjera.

**Marrin pjesë:**

Majlinda Bregu, Esmeralda Shkja, Arben Imami, Ilir Xhakolli, Taulant Balla, Bujar Derveni, Gramoz Ruçi, Sadri Abazi dhe Kejdi Mehmetaj.

**Mungojnë:**

Edi Paloka dhe Gerti Bogdani.

**Të ftuar:**

Milena Harito – ministre e Inovacionit dhe Administratës Publike.

Irena Malolli – përfaqësuese e Ministrisë së Inovacionit dhe Administratës Publike.

Stela Ademi – specialiste e Sektorit të Përafrimit të Legjislacionit në Ministrinë e Integrimin Europian.

Majlind Lazimi – drejtor i Postës Shqiptare.

## HAPET MBLEDHJA

**Majlinda Bregu** – Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen me këtë rend dite: si pikë të parë të rendit të ditës kemi si gjithmonë miratimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar të komisionit. Besoj se jeni dakord, sa kohë nuk ka njeri që të jetë kundër, si dhe shqyrtimin e projektligjit “Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë”.

Të ftuara nga Ministria e Inovacionit dhe Administratës Publike kemi zonjën Milena Harito, ministre, dhe zonjën Irena Malolli, nga Posta Shqiptare: zotin Majlind Lazimi, drejtor, nga Ministria e Integritimit Europian: zonjën Stela Ademi, por sigurisht edhe përfaqësuesin e Njesisë së Përafrimit të Legjislacionit në Kuvend.

Mirë se erdhët!

Atëherë, zonja Ministre, duke qenë se keni ardhur në komision për ligjin e shërbimit postar, nuk e di nëse do të na bëni ju një prezantim të shkurtër të projektligjit.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Je i paftuar!

**Taulant Balla** – Jo, jo!

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Majlinda Bregu** – Me shkresë.

Ke të drejtë, në fakt, se unë nuk e ngrita kokën as të të shihja që ishe këtu, Majlind, kështu që të kërkoj ndjesë!

Megjithatë, ne e dimë që je drejtori i Postave. Kështu që mirë se erdhe edhe ti, megjithëse i paftuar!

**Taulant Balla** – Të gjithë zëvendësministrat e Integritimit i ka inat Majlinda.

**Majlinda Bregu** – Jo, ministrat dhe zëvendësministrat e Integritimit, të cilët kanë punuar...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Jo, jo.

Kjo është batutë kot tani, nuk ka lidhje me mua. Ka të bëjë me inatin që ke ti me të gjithë ata të qeverisë që ishte, por unë e kam me...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Ka hyrë në fushatë Taulanti.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

E ka problemin shumë të madh, që kur ka filluar të mos jetë më elegant nëpër emisione televizive. Që të kuptohemi, është mëngjesi i ditës së hënë ky; ishte sa për nxehje.

Fjala për ju, zonja Ministre.

**Milena Harito** – Faleminderit!

Mirëdita të gjithëve!

Po bëj një paraqitje të përgjithshme të projektligjit.

Projektligji mbështetet në dy shtylla.

Çështja e parë është përafrimi me legjislacionin dhe direktivat e Bashkimit Europian, siç është e parashikuar në Planin Kombëtar të Integritimit e miratuar në vitin 2014, pra për periudhën 2014-2020, kurse çështja e dytë me përmirësimin e ofrimit të shërbimit postar.

Kjo është një lëvizje liberalizuese, e ndjekur në të gjithë Bashkimin Europian për tregun postar. Tregu postar, ashtu si tregu i telekomunikacioneve përpara tij, ka qenë treg monopolistik dhe më pas ka shkuar drejt një lëvizjeje liberalizuese dhe hapjeje drejt operatorëve privatë.

Ajo që mund të kujtojmë këtu është që ligji aktual që rregullon shërbimin postar, dhe dua të sjell në vëmendjen tuaj që ky ligj rregullon vetëm shërbimet postare të Postës Shqiptare dhe jo shërbimet financiare, të cilat rregullohen nga një ligj tjetër, daton prej vitit 1999, kur në tregun shqiptar operonte vetëm operator “Posta Shqiptare”, dhe që nga ajo kohë në tregun shqiptar operojnë rreth 11 ofrues shërbimesh postare. Pra, tregu është tashmë dinamik. Për këtë arsye duhet rregulluar në përputhje me tregun dhe qëllimi është sigurisht përmirësimi i shërbimit, ofrimi i shërbimeve të reja dhe përmirësimi i tarifave në përgjithësi të këtij tregu.

Ajo që mund të kujtojmë është se tregu i shërbimeve postare është i prekur në mënyrë të rëndësishme nga zhvillimet teknologjike, sepse një pjesë e madhe e komunikimeve kalojnë tashmë nëpërmjet komunikimeve elektronike. Kështu që ky treg ka pësuar ndryshime të mëdha.

Ajo që mund të kujtojmë është, për shembull, që vitin e kaluar pati një rritje me rreth 21% të objekteve postare, që i trajton Posta Shqiptare, dhe kjo vjen sigurisht edhe për shkak të rritjes së tregtisë elektronike. Ndërkohë mbetemi në shifra të llojit nga 21 milionë objekte postare, mbi 19 janë të shpërndara prej Postës Shqiptare. Pra, është një treg që ka nevojë për një rishikim dhe një rregullim të ri në përputhje me *Acquis*-në dhe në shërbim të qytetarëve.

Gjithashtu mund të nënvizojmë se parashikohet një periudhë tranzitore deri në fund të vitit 2016 për të mos lëkundur në mënyrë të rëndësishme aktivitetin e Postës Shqiptare për zonën e rezervuar, që është zona për letrat nën 50 gramë. Për dijeninë tuaj, kjo zë një pjesë

shumë të vogël të të ardhurave të Postës Shqiptare, sepse sigurisht është edhe pjesa më pak fitimprurëse.

Këto janë disa parime të përgjithshme.

Nëse do të keni pyetje ose sugjerime, jemi të hapur.

Ju faleminderit!

**Majlinda Bregu** – Ka ndokush ndonjë gjë për të shtuar? Nuk ka?

Ministria e Integrimit European e ka përcjellë mendimin me shkrim që projektligji është në përputhje me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit dhe me rekomandimet e progresraportit të vitit 2014, po ashtu me Planin Kombëtar të Integrimit, ndaj nuk besoj se keni ndonjë gjë.

Për sa i përket pjesës së përputhshmërisë me *Acquis*-në, Njësia e Përafrimit të Legjislacionit në Kuvend, përveç shprehjes se ka një përputhshmëri të plotë, ka disa sugjerime, të cilave ndoshta mund t’u kthehemi në rast se do të ketë pyetje apo komente, për të diskutuar edhe për sugjerimet e kësaj Njësie. A ka pyetje nga kolegët? Nuk ka. Ka komente? Nuk ka.

Zonja Ministre, përmendët tarifat e ndryshueshme në këtë ligj. A mund të më thoni se për çfarë tarifash bëhet fjalë dhe si ndryshojnë?

**Milena Harito** – Bëhet fjalë për tarifën e asaj që quhet “zona e rezervuar”, pra për letrat nën 50 gramë. Kjo është pjesa e rregulluar nga ligji, ku duhet të ofrohet shërbim universal.

Vlen të kujtohet se kjo tarifë është parashikuar që të ulet që në vitin 2002 dhe duhet të ishte përafruar sipas direktivave të Bashkimit European deri në vitin 2006 (duhet të ishte realizuar). Në të vërtetë nuk është realizuar.

Një ulje e zonës së rezervuar është realizuar vetëm në vitin 2013 dhe ligji shkon në këtë drejtim, pra për t’u përputhur me rrugën e parashikuar për zonën e rezervuar të Postës. Nëse doni një shpjegim teknik më të detajuar...

**Majlinda Bregu** – Pra, ju thoni se bëhet fjalë për ulje të tarifës.

**Milena Harito** – Të zonës së rezervuar.

**Irena Malolli** – Unë do ta saktësoja duke thënë: “për rregullimin e tarifave që kanë të bëjnë me ofrimin e shërbimit universal postar”.

Ligji ka plotësime kundrejt kuadrit ekzistues ligjor për sa i përket rregullimit të tarifave. Në veçanti, në nenet 26, 27 dhe 28 kemi parashikime për parimet e vendosjes së tarifave të shërbimit universal postar. Njëkohësisht kemi parashikuar edhe mekanizmat rregullues të këtyre tarifave dhe ndërhyrjen e organit rregullator, që është AKEP-i, në rastet e

nevojshme, pra kur tarifat e vendosura nga një ofrues i shërbimit universal nuk janë në përputhje me përcaktimet ligjore.

Faleminderit!

**Majlinda Bregu** – Faleminderit!

Në rast se do t'u referohemi komenteve që ka bërë Njësia e Përafrimit të Legjislacionit në Kuvend, të cilat, me sa shoh, nuk janë vetëm të natyrës të formulimit dhe të riformulimit, ka disa komente të cilat kanë të bëjnë kryesisht me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, të cilat janë kompetencë e AKEP-it, apo jo, ndërmjet përdoruesve të shërbimeve postare dhe ofruesit të shërbimeve postare.

Sipas Njesisë së Përafrimit të Legjislacionit në Kuvend, në ligj përdoren dy standarde për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Unë besoj që këto rekomandime dhe komente, të cilat janë përcjellë me shkrim, do të duhet t'i pasqyroni në ndryshimin që keni para se ligji të miratohet dhe të vijë për votim në seancë plenare. Në rast se ju do të keni komente të tjera mbi to, do t'i shihni ose jo si të qenësishme për t'u pasqyruar, do t'ju lutesha të na dërgoni një informacion për çdo koment, pra mos i merrni vetëm rekomandimet dhe përfundimet, të cilat janë në këtë analizë të Njesisë së Përafrimit të Legjislacionit në Kuvend, vetëm si një përcjellje të një materiali shkresor, por do të donim të na përcillnit vlerësimin tuaj se si i shihni këto komente, sugjerime dhe rekomandime, të cilat, e përsëris me sa shoh, nuk janë vetëm të natyrës riformuluese, por që pjesa më e rëndësishme është pikërisht ajo që ka të bëjë me përplasjen e së drejtës së kontrollit dhe të ankesës që bëhet nga qytetarët tek ofruesit e shërbimeve postare.

Ka ndonjë gjë tjetër, zoti Kasneci?

Po, urdhëroni!

**Dedë Kasneci** – Faleminderit, zonja kryetare!

Paraprakisht e kemi diskutuar dhe përfaqësuesit e qeverisë janë dakord me sugjerimin tonë.

**Majlinda Bregu** – Faleminderit!

Shumë mirë që jeni treguar të shkathët dhe e keni diskutuar paraprakisht. Mirë do të jetë që edhe të na e përcillnin informacionin dhe ky do të bëhej rregull për të gjitha komunikimet tona kur institucionet ta përcillnin me shkrim se sa i marrin në konsideratë vërejtjet, propozimet dhe sugjerimet e Kuvendit dhe të Njesisë së Përafrimit të Legjislacionit në Kuvend.

*(Zoti Kasneci ndërhyr pa mikrofon.)*

Në qoftë se ke diçka tjetër për shtuar, me leje.

**Dedë Kasneci** – Vendimmarrja është juaja. Ne sugjerojmë, diskutohet me përfaqësuesit e qeverisë dhe pastaj vendimi është juaji. Çështja nuk është që ato të shprehen me...

**Majlinda Bregu** – E kam të qartë dhe ne pikërisht, duke e marrë parasysh se vendimmarrja jonë është në përputhje me mendimet tuaja, po u kërkojmë përfaqësuesve të qeverisë që të marrin parasysh mendimet tuaja duke i bashkëngjitur vendimmarrjen tonë.

Faleminderit!

Ka ndonjë pyetje, koment, sugjerim, përveçse e keni mendjen të gjithë për të ikur për t'u marrë me fushatë?

*(Diskutime në sallë.)*

Pse e lë gjithmonë fjalën për në fund ti, Taulant?

**Taulant Balla** – Nuk kam çështje që lidhen me projektligjin, por meqenëse këtu është edhe ministrja, edhe drejtori i Përgjithshëm i Postës Shqiptare, thjesht më shumë edhe një interesim, por edhe një shtysë për forcimin e shërbimit shtetëror postar, sepse Posta Shqiptare është shërbimi postar shtetëror dhe pak kohë më parë kemi diskutuar edhe në komision se si Posta Shqiptare duhet të zgjerojë veprimtarinë e vet edhe në drejtim të shërbimeve bankare.

Ka qenë një ide ndër vite, apo jo, Majlind, që Posta Shqiptare të mund të shndërrohet në një postë-bankë, sikurse është modeli i saj i ngjashëm në vende të ndryshme, kryesisht ai gjerman, austriak apo edhe në vende të tjera. Kështu që, nëse mund të na thoshe shkurt, 2-3 minuta, çfarë po bën Posta Shqiptare në këtë drejtim.

Faleminderit!

**Majlinda Bregu** – Po, zoti Lazimi.

**Majlind Lazimi** – Faleminderit!

Do të dua të jem shumë sintetik, sepse e di që pyetja e zotit Balla është pak jashtë fokusit të diskutimit për projektligjin. Në fakt, dua të them dy gjëra shkurtimisht për projektligjin dhe pastaj, nëse është e mundur, të kthej përgjigje për pyetjen.

Besoj se ky projektligj në tërësi sjell ndryshime pozitive për sa i përket jo thjesht transpozimit të *Acquis Communautaire*, pra transpozimit të direktivave të vitit 2008 për sa i përket ligjit të shërbimit postar, por rregullon një sërë aspektesh teknike, administrative dhe logjistike për sa i përket këtij shërbimi universal, që tashmë me ligjin aktual quhet shërbimi bazë. Ka një frazë të re, por ka një definicion të ri “shërbimi postar”.

Ne kemi punuar bashkërisht me Ministrinë e Inovacionit për të pasur një draft të përbashkët, që është drafti final që kemi sot. Pa dyshim që kemi dy-tri pika, të cilat i

diskutuam në komisionin përkatës të Ekonomisë dhe Financave, kryesisht për sa i përket shpejtësisë se si do të liberalizohet ky treg dhe, në këndvështrimin tonë, të paktën për sa i përket zonës së rezervuar, e cila parashikon deri në 50 gramë, do të dëshironim një kohë më të gjatë për shkak të nevojave pastaj për ristrukturim, duke pasur parasysh që zona e rezervuar është aktualisht 40% e të ardhurave të shërbimit tonë postar. E thënë në vlerë absolute, është rreth 300 milionë lekë në vit dhe pa dyshim kjo ka një taksë gjithësi në të ardhurat e kompanisë “Posta Shqiptare”, për të cilën ne nuk besojmë që ky impakt do të jetë i menjëhershëm dhe total, sepse ne besojmë që kemi një lloj tregu, ku realisht ofrojmë shërbim konkurrencial edhe në raport me operatorë privatë, por ne besojmë se një kohë më e gjatë, duke pasur parasysh që viti 2016 është gati më pak se dy vjet që sot dhe duke pasur parasysh që kemi edhe aktet nënligjore, të cilat, në rastin më të mirë, duhet të përfundojnë brenda këtij viti, operatorëve në treg, sikurse Postës Shqiptare, është mirë t’u jepet më shumë kohë për të reflektuar edhe strategjitë e tyre të zhvillimit. Kjo është njëra pikë që unë besoj se aktualisht, për hir të së vërtetës, pavarësisht se kemi zonën e rezervuar prej 50 gramësh, ka raste tipike në treg, ku operatorë privatë e ofrojnë këtë shërbim. Ndoshta do të ishte e arsyeshme që AKEP-i të kishte kapacitete më të larta monitoruese për të parë tregun.

Gjithësi, projektligji i ri i jep më shumë kompetenca AKEP-it, jep mundësinë që të kemi një skemë financuese për sa u përket kostove neto, dhe këtu ministrja e parashitroi si draft. Pra, ideja është që do të ketë një kompensim financiar për operatorët, në rast se ky shërbim ofrohet nën kosto apo kostoja e këtij shërbimi, në fakt, është më e lartë sesa tarifa që ne marrim, duke qenë se Shqipëria është një relief deri diku i vështirë nga ana gjeografike. Ka komuna, ndoshta edhe bashki të vogla, ku efektet financiare të tarifës, që ne marrim për shërbimin që kryejmë, janë më të vogla sesa kostoja e këtij shërbimi. Megjithatë, kjo është çështje teknike që unë besoj se është jashtë fokusit të këtij komisioni.

Një pikë e dytë, e cila mendoj se ka rëndësi, është pjesa e shërbimit universal, pra të ofrohet nga një kompani, nga një ofertues apo nga disa. Direktiva është e hapur, thotë “një a më shumë”, por ajo çka ne duam, si Postë Shqiptare, është fakti që, nëse do të ketë më shumë se një ofertues të shërbimit universal, do të ishte mirë që ky shërbim të ofrohej në të gjithë Shqipërinë, sepse germa “c” e nenit 11 krijon një lloj hapësire për të pasur fragmentarizim të shërbimit postar. Pra, jo domosdoshmërisht një kompani, qoftë ky operator privat i licencuar për shërbim universal postar, mund ta ofrojë shërbimin në të gjithë Shqipërinë; mund të ofrojë shërbime të dedikuara për lokalitete të caktuara. Kjo, në këndvështrimin tonë, jo thjesht për të ruajtur një lloj dominancë në treg, por besoj se për të ruajtur një lloj harmonizimi të shërbimit do të ishte mirë që ta ofronin në të gjithë Shqipërinë.

Jemi të gatshëm që pastaj në rregullat e lojës së konkurrencës të konkurrojmë me kë të dojë i cili mund të ofrojë shërbim në të gjithë territorin.

Këto janë dy komentet tona që ne i kemi bërë me dije edhe në Komisionin pararendës të Ekonomisë dhe Financave, gjë që besoj do ta ngremë edhe nesër në Komisionin përkatës të Veprimtarive Prodhuese.

Duke u kthyer te përgjigjja për sa i përket pyetjes së zotit Balla, është e vërtetë, sot që po flasim rreth 49% e të ardhurave tona vjetore vijnë nga shërbimi postar. Pra, posta ka humbur pjesën tradicionale të aktivitetit të saj, dhe kjo nuk është tendencë vetëm shqiptare, por rajonale dhe europiane, ku postat, për shkak të tendencave teknologjike të internetit dhe humbjes apo zbehjes së rëndësisë që ka një kartolinë apo një letër dërguar me zarf brenda territorit shqiptar, normalisht do të duhet të gjejmë burime të tjera alternative të të ardhurave. Kjo gjë është bërë ndër vite nga Posta Shqiptare, ndërkohë sot që po flasim rreth 50% e të ardhurave tona, që i bie rreth 9 milionë dollarë në vit, i sigurojmë përmes shërbimeve financiare bankare, që unë besoj se është një shtyllë e rëndësishme e kompanisë “Posta Shqiptare”, duke pasur parasysh që është një kompani publike, e cila sot punëson rreth 2280 punonjës. Pra, ka edhe një efekt social prapa kësaj strategjie.

Në këndvështrimin tonë afatmesëm është e pashmangshme strategjia jonë për të kaluar në një postë-bankë, sepse unë besoj që tashmë me rrjetin tonë kapilar në të gjithë Shqipërinë, me eksperiencën e akumuluar ndër vite për shërbimet financiare të arkëtimeve, jo vetëm të arkëtimeve, por edhe të shërbimeve të ndryshme bankare, së fundi ne kemi ndërmarrë një fushatë goxha agresive, në fakt, për të bashkëpunuar edhe me bankat për disa shërbime, siç është rasti i pagesave të kësteve të kredive, që ne kemi nënshkruar me disa banka, ku bankat nuk kanë prezencë, por kërkojnë që klientët e tyre të mos i humbasin. Padyshim që këta klientë mund të paguajnë këstet e kredive në zyrat postare dhe ne pastaj bëjmë, përmes një komisioni shumë minimalist, kalimin e këtyre parave në llogaritë e këtyre bankave. Pra, logjika është që kjo është tendencë e kohës dhe e vetmja mënyrë që një treg, i cili sa vjen e bëhet më agresiv, të mbijetojë, aq më tepër duke pasur parasysh efektet rregulluese dhe tendencat liberalizuese që do të ketë në të ardhmen.

Jemi të hapur që të ndjekim këtë trajektore.

Faleminderit!

**Majlinda Bregu** – Faleminderit, Majlind!

Besoj se edhe zoti Balla u sqarua. Duhet ta falënderosh edhe për mundësinë që të dha që, edhe pse kishin harruar të të ftonin, të na bëje një pasqyrim shumë të saktë të sukseseve ose të sfidave që do të ketë Posta Shqiptare.



Atëherë, biem dakord me projektligjin? Kundër guxon ndonjëri? Nuk guxon.  
Abstenim? Nuk ka.

Faleminderit që ishit në komision!

Zonja Ministre, do të duhet të riktheheni për prioritetin nr.1 “Administrata publike”  
sapo t’ju bëjmë gati shkresën.

Faleminderit për pjesëmarrjen!

## **MBYLLET MBLEDHJA**